

Jetë me dinjitet për të gjithë punëmarrësit!

Diskriminim në shkollim profesional

Shembull përmes një portreti

2

Pagë minimale për të gjithë

Përse i nevojitet Zvicrës paga minimale?

3

Lufta e punëtorëve në Kosovë

Solidarizimi Jemi me ju – grevistë!

4

Nr. 2 | prill 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

1 Maj 2014

Punë të mirë – paga minimale për të gjithë



Në shumë sektor mbi 330000 punëmarrës fitojnë më pak se 4000 Franga

Këtë vit është e rëndësishë së veçantë që të gjithë ne të mbushim rrugët. Ne gjendemi në një udhëkryq si në Zvicër ashtu edhe në Evropë. A duam të ndërpresim që disa të fitojnë gjithmonë e më shumë, ndërsa tjerët gjithnjë e më pak? A duam që disa të kenë më pak të drejta se sa të tjerët? Apo duam ne kushte më të mira pune për të gjithë? Ne do të duhej të ishim më solidar, pasi vetëm përmes solidaritetit për të gjithë punëmarrësit – si për migrantët apo zviceranët, burrave dhe grave, të rinjve dhe të moshuarve – do të bëhej më mirë dhe do kishin punë më të mirë! Për këtë duhet të angazhohemi dhe të vë shojmë rrugët të gjithë ne më 1 maj!

Në gjendemi në me të betejës votuese për pagën minimale, mbi të cilën do të votohet më 18 maj. Kjo në ditën e sivjetme ndërkombëtare të punës, më 1 maj do të jetë në qendër të vëmendjes.

Një çështje e drejtësisë sociale

Argumentet për pagën minimale janë të shumta. Mirëpo ne duam të theksojmë në mënyrë të veçantë atë të shpërndarjes së drejtë dhe drejtësinë sociale. Posaçërisht në një vend të pasur si Zvicra, do të duhej të kishte mjaftueshëm për të gjithë. Megjithatë vetëm një pakicë e vogël të posedojë shumicën e pasurisë së vendit është e padrejtë. Do të duhej të kishte mjaftueshëm për të gjithë! Këtë të pasur shpesh janë po ata, që punëmarrësve të tyre u paguajnë paga të mjerueshme, edhe përkundër punës së vështirë. Nëse pronarët paguajnë pak, atëherë duhet të paguajnë tatimpaguesit. Pasi që të gjithë njerëzit që nuk fitojnë mjaftueshëm për të jetuar, edhe përkundër punësimit me orar të plotë, janë të detyruar të drejtohen për ndihmë sociale.

Përfundimisht barazi pagash

Iniciativa për pagën minimale ka të bëjë edhe me barazinë mes gjinësh. Gratë janë posaçërisht të prekura nga

pagat e ulëta, edhe pse edhe ato e bëjnë punën mirë! Por, profesionet tipike të grave kompensohen keq. Paga minimale pos tjerash do të kontribuonte për barazinë në paga dhe do tu siguronte shumë grave paga korrekte.

Mbrojtje të pagave

Paga minimale ligjore prej 4000 frangash ka fituar në rëndësi pas aprovimt të iniciativës mbi migrimin masiv. Tani është rrezikuar qarkullimi i lirë i njerëzve, sikur edhe marrëveshja bilaterale. Masat për mbrojtjen e pagave në Zvicër janë të ndërlidhura fuqishëm me qarkullimin e lirë të njerëzve. Nëse humbë qarkullimi i lirë i njerëzve nuk do të ketë arsye të ruajtjes së masave mbrojtëse. Pa masa mbrojtëse të pagave rritet rreziku që të përkeqësohen kushtet e punës për të gjithë.

Bashkë jemi më të fortë!

Punëmarrësit duhet të jenë të bashkuar – ne tani më shumë se kurrë kemi nevojë për një lëvizje të fuqishme sindikaliste. Një votim tjetër i rëndësishëm na pret pas 18 majit. Votimi për iniciativën «Ecopop», e cila parashihet kufizime më të mëdha karshi migrimit, e për të cilën sipas të gjitha gjasave do të votohet qysh këtë vit. Në se kalon kjo iniciativë,

atëherë kjo njëherazi paraqet fundin e marrëveshjes bilaterale dhe qarkullimit të lirë të njerëzve. Pasoja do të ishin në radhë të parë reduktimi i të drejtave të migrantëve. Konkretisht, do të humbet siguria e lejes së qëndrimit. Dhe ato do të lëshohen vetëm për kohë të shkurtë. Dhe kush nuk ka siguri qëndrimi bëhet më lehtë i shfrytëzueshëm dhe fuqizon pronarët. Ne nuk mund të lejojmë diç të tillë, pasi që do të vuajnë të gjithë nga përkeqësimi i kushteve të

punës. Andaj ne duhet të jemi solidar me njëri tjetrin.

⇒ Aurora García

Pra të gjithë në rrugë më 1 maj 2014! Më shumë informata për 1 majin shih ueb faqen e Unionit të Sindikatave Zvicerane (SGB/USS) www.sgb.ch/www.uss.ch.



Pllakati i sivjetmë për manifestimin e 1 majit

Editorial



Të dashura lexuese e lexues

Rezultati i votimit të 9 shkurtit tek disa nga ju ka shkaktuar pasiguri. Çka do të ndodh tani? Të tjerë mendojnë, nuk do të ketë ndryshime të mëdha. Fillimisht: Tani për tani nuk ndryshon asgjë. Qytetarët e BE-se edhe më tej i nënshtrihen qarkullimit të lirë të personave. Kjo d.m.th. një qytetar i BE-së sikur deri më tani mund të realizojë bashkimin familjar në Zvicër si dhe posedon edhe më tej të drejtën e lejes B të qëndrimit me rastin e kontratës së pakufizuar të punës. Mirëpo është e vërtetë se disa çështje tani janë të hapura. Së pari shtrihet pyetja se si do të vijojë puna e marrëveshjes bilaterale dhe qarkullimin e lirë të personave. Tani për tani nuk mund të japim përgjigje në këtë pyetje. Mirëpo këto janë të rrezikuara dhe çka është me rëndësi edhe të drejtat e migrantëve e migrantëve. Kështu përfaqësues të partive borgjeze SVP dhe FDP pas votimit sugjerojnë më pak lejë afatgjate dhe më shumë afatshkurtra, pra fuqi punëtoresh me më pak të drejta, të cilët posaçërisht fare pak mund të mbrohen nga përkeqësimi i kushteve të punës.

Në anën tjetër shtrihet pyetja, si do të vejë më tej çështja e shoqërisë zvicerane. 9 shkurti paraqet për të gjitha forcat përparimtare një humbje të madhe. Sindikata Unia pas një analize vetëkritike ka arritur në përfundim se duhet vepruar! Bashkë me 60 organizata ftuam një manifestim demonstrues për datën 1 mars 2014 me moton «Për një Zvicër të hapur dhe solidarë». Rreth 10000 njerëz iu përgjigjën ftesës sonë, me çka u vërtetë se këta njerëzit duan të ndryshojnë diçka! Ne duam një shoqëri, e cila mbështetet në respektim dhe solidaritet dhe si e tillë i mbron të drejtat e të gjithëve, gjë që shërben konkretisht për kushte të mira pune. Vetëm të bashkuar ia arrijmë këtij qëllimi!

Aurora García

Sekretare sindikale për migracion

News


Zgjidhje për kantierin: ZARA



Në rastin e dumpingut në paga në kantierin ZARA në rrugën «Bahnhofstrasse» të Cyrihut u arrit një zgjidhje. Dega e Inditex-it GOA Invest S.A. merr përsipër përgjegjësinë për gabimet e nën-ndërmarrjeve dhe siguron, se të 450 000 frangat janë bërë gati për pagesën e mbetur të rreth 100 punëtorëve të prekurve. Punët në kantier kana vazhduar të kryhen.

Unia ka nisur një iniciative popullore kantonale kundër dumpingut nëm paga, e cila obligon zyrtarëve që në rast të dyshimit të mbështetur për dumping në paga të ndërpriten puna, deri në kohën kur punëdhënësi ose i përbahet dëshmueshëm kushteve korrekte të punës, ose ka kryer përfundimisht detyrimet për paga të mbetura. Teksti i iniciativës në fjalë do të dorëzohet qysh këtë javë nga ana e sindikatës Unia për kontroll të obligueshëm.

Aeroporti i Gjenevës: Pilotët fitojnë vetëm 2000 Franga



Në fillim të marsit Unia ka publikuar një rast të frikshëm të dumpingut në paga. Në aeroportin ndërkombëtar të Gjenevës, Pilotët dhe personeli shoqëruës i aeroplanëve të gjenisë private të fluturimeve Sonning SA marrin një pagë mujore prej vetëm 2000 Frangave për punën me orar të plotë. Përmes një aksioni të punësuarit e prekur të mbështetur edhe nga Unia protestuan kundër këtij skandali të pagave tejet të ulëta.

Konferenca e migracionit: të Unia-s

Më 10 maj mbahet konferenca vjetore e migracionit të Unia-s, në të cilën janë ftuar delegatët nga regjionet, si dhe të mirëseardhur si mysafir janë edhe anëtarët e interesuar të Unia-s. Në aspektin tematik kjo konferencë do të merret posaçërisht me aprovimin e iniciativës kundër migrimit masiv.

Ekonomi shtëpiake, Personat pa letra

Peticion për të punësuarit pa status të rregulluar në amvisni

Më 5 mars shoqata «të vlerësohet puna në ekonominë shtëpiake – të rregullohen ligjërisht personat pa letra» ia dorëzoi qeverisë federale një peticion me 21875 nënshkrime. Shoqata që përbëhet nga 30 Organizata anëtare, ndër të cilat edhe Unia, kërkonë përmes këtij peticioni lejen e qëndrimit për punonjësit në amvisni, të cilët nuk e kanë të rregulluar qëndrimin, për mbrojtje sociale dhe qasje në gjyqësi pa rrezikun për dëbim nga Zvicra.



Pamje nga një aksion solidariteti me të punësuarit pa status të rregulluar

Rreth 100 persona vallëzuan me fshesa dhe mjete tjera për pastrim përmes Bernës deri tek zyra federale, ku i dorëzuan qeverisë peticionin me 21875 nënshkrime për më shumë të

drejta për punonjësit në amvisni pa leje qëndrimi të rregulluar qëndrimi. Kështu të nënshkruarit – ndër ta edhe ish kryetarja e Zvicrës, Ruth Dreifuss apo regjisori me nam, Fernand Mel-

gar – që qeveria zvicerane:

1. Të legalizoj lejet e qëndrimit për të punësuarit pa leje qëndrim të rregulluar, posaçërisht për ata që janë duke punuar në sektorin për amvisni.
2. Garantimi i mbrojtjes sociale për punonjësit në ekonominë shtëpiake pa qëndrim të rregulluar, pa rrezikun për tu dëbuar nga Zvicra
3. Qasje në gjyqësinë e punës

Kryetarja e shoqatës Elisabeth Joris paralajmëroi të kihet kujdes që me rastin e ndryshimeve restriktive ligjore nga fusha e migracionit, të mos barten pasojat tek personat pa letra (pa leje qëndrimi të rregulluar). Me fuqizimin e mëtejme të masave të rrepta sa i përket parakushteve për migrim, situata e punonjësve në eko-

nomit shtëpiake pa leje të rregulluar qëndrimi bëhet edhe më e vështirë.

Aktivitetet regjionale

Grupet regjionale janë edhe më tej aktive. Posaçërisht duhet potencuar ekspozitën lëvizëse në Cyrih, e cila pasqyron anketën e kampanjës me vepra artistike. Kjo ekspozitë do të qëndron nga 4 prilli në Bernë, ku do të ndërroj vendet e ekspozimit deri më 22 prill. Pas koncertit e solidaritetit për persona pa letra më 25 prill në «Heiliggeistkirche» ekspozita e kompletuar mund të vizitohet po në «Heiliggeistkirche» deri më 11 maj. Më shumë informata mbi kampanjën mund të gjeni në: www.khii.ch, www.ncdei.ch, www.aemni.ch

Aurora Garcia

Photos: Salvatore Pittà



Me rastin e dorëzimit të peticionit

Portret

Diskriminimi në tregun e shkollimit profesional

Një njeri është një njeri dhe jo vetëm emër

Shqipe Mahmutaj është duke u shkolluar si shitëse me pakicë dhe ka plane të mëtejme arsimore për të ardhmen. E lindur në Kosovë, Shqipe Mahmutaj ka gjetur një vendshkollimi të mirë profesional. Edhe përkundër prejardhjes. Mirëpo rrua deri të kjo arritje ishte e mundimshme, pasi diskriminimi në botën e punës prek edhe fëmijët e migrantëve.

Shqipe Mahmutaj thotë: «Ta zëmë se unë do të quhesha Silvia Müller. Unë do të arsimohesha në profesionin e komercialistit.» 19 vjeçja e sotme i ka dërguar mbi 130 aplikime për arsimim në profesionin e komercialistit përgjatë një vit e gjysmë para përfundimit të shkollimit. Pa sukses. «Dy, tri herë arrita të shkoj deri në bisedë prezantuese. Mirëpo në fund nuk doli asgjë as nga to.» Edhe përkundër faktit të theksuar se Shqipja ishte nxënëse e mirë, notat e saja në shkollën sekondare ishin mes notës 4-5 dhe 5-6. Për zviceranen me rrënjë nga Kosova është e qartë «Si problem shihet emri im. Edhe pse mua kjo nuk më është thënë hapur si arsye e refuzimit e diskriminimit. Mirëpo, pavetëdijshëm kjo luaj një rol.»

Edhe përkundër notave të mira pa vendshkollimi profesional

Shumë hulumtime e studime vërtetojnë këtë supozim. Në rastin e rezultateve të njëjta shkollore, shanset e të rinjve me sfond të huaj për një vendshkollimi profesional janë katër herë më keq. Shkenca vërteton se kjo situatë pra nuk shpjegohet me deficite shkollore. Këtu një rol kyç

luajnë paragykimet karshi të rinjve me prejardhje të huaj, para së gjithash karshi atyre të Ballkanit dhe ish Jugosllavisë.

Vendbanimi si barrierë

Diskriminimi fillon me vogëlsira, thotë Marianne Helfer nga qendra kompetente për integrim në qytetin e Bernës: «Unë kam dëgjuar shumë herë se shanset e këqija kanë të bëjnë me numrit postar të vendbanimit të atyre që aplikojnë për vendshkollim profesional.» Në Bernë kjo situatë prek pjesën perëndimore me lagjet tradicionale punëtore si Bümplitz dhe Bethlehem. Këto lagje dominohen nga vendbanimet e vjetra dhe të mbipopulluara me përbërje të madhe të të huajve.

I rëndësishëm këshillimi dhe mbështetja

Edhe Shqipe Mahmutaj banon në pjesën perëndimore të Bernës bashkë me motrën binjake dhe nënën e saj. Vajzat kanë lindur këtu, ndërsa e ëma ka ardhur para disa dekadave në Zvicër bashkë me burrin e vdekur në ndërkohë dhe e tërë familja ka shtetësi zvicerane. Familja ka qenë mbështetja kryesore e Shqipes «në situatat e dëshpërimit dhe humbjes së shpresës kur për çdo javë vinin refuzimet». Një vit të tërë ajo bashkë të ëmën ishin vizitore të rregullta të Këshillimores për përzgjedhjen e profesionit në kuadër të punës së hapur me rini në Bernë. «Çdo të mërkurë dhe të premte pasdite aty kam përpunuar aplikimet e mija dhe jam këshilluar.»

Fleksibiliteti ka dhënë fryte

Me kalimin në vitin e dhjetë shkollor, Shqipja



Shqipe Mahmutaj

bind veten: «Mua më duhet një plan B». Ajo fillon të aplikojë për vendshkollim profesional si shitëse me pakicë. Sukseshëm. Nga Posta ku kishte marrë refuzimin për aplikimin si komercialistë, kësaj radhe morri aprovimin. Në ndërkohë vijon vitin e parë në selinë e Postës në paralagjen Muri të Bernës. Shqipja është «e lumtur se kam zbkruar këtu. Puna është sfiduese, e larmishme dhe interesante. Edhe koleget e kolegët janë të këndshëm dhe miqësor. Kujdestari im vjen gjithashtu nga Kosova, ndërsa racizmi dhe diskriminimi nuk vijnë në shprehje.»

Pas shkollimit profesional, Shqipe Mahmutaj dëshiron të përfitojë nga oferta e Postës për një vit qëndrimi në Zvicrën Perëndimore (franceze). Se çka do të bëjë më tej, tani për tani nuk e din me saktësi. Maturën profesionale ose karrierë në Post – apo police? Sidoqoftë «unë do të interesohem edhe për diçka tjetër përpos shitjes.»

Një njeri, pa emër

Kërkueset/it tjerë të vendshkollimit profesional me sfond migracioni Shqipja i këshillojnë të mos investojë gjithçka vetëm në një kartë. «Nevojiten dy, tri qëllime.» Ajo do të preferonte aplikimet anonime, ashtu si i kanë testuar sukseshëm Zvicra perëndimore dhe Cyrihu. Pasi «të gjithë duhet të kenë një shanse. Një njeri është një njeri dhe jo vetëm emër.»

Matthias Preisser, e përshtatur nga «work Lehre Spezial» Photo: Yoshiko Kusano Fotografija: Yoshiko Kusano

Shërbimi, Shtatzënia

Shtatzënë: Këto duhet ti dini medoemos



Për gratë e punësuar shtatzëna vlejnë të drejta speciale.

Ju pritni një fëmijë? Kur mbeteni shtatzënë lindin shumë pyetje – shëndetësore, personale dhe profesionale. Në vijim do të trajtojmë disa nga këto pyetje. Çka ju medoemos duhet të dini: Për ju vlejnë të drejta speciale. Këtu vlen edhe mbrojtja e pushimit nga papa.

Kur informoni?

Nëse keni kontratë të plotë pune? Atëherë nuk keni nevojë të njoftoni shefin apo shefen tuaj. Ju keni të drejtën të mos deklaroni shtatzëninë tuaj, edhe në rast se për këtë ju pyesin. Mirëpo është kuptimplote informimi i mbikëqyrësit tuaj, pasi posa të mësoj firma juaj mbi këtë, është e obliguar të mbrojë shëndetin e juaj. Ashtu kështu ju përfitoni nga mbrojtja speciale e vendit të punës për shtatzëna. Kjo vlen gjatë shtatzënisë dhe deri 16 javë pas lindjes. Vetëm nëse jeni në kohë provuese të punës, firma megjithatë mund të ju pushojë nga puna.

Reduktimi

Ju mund të reduktoni orarin e juaj të punës gjatë shtatzënisë, mirëpo kështu zbritet edhe kompensimi me rastin e pushimit të lehonisë. Financiarisht për ju nuk ia vlen reduktimi i orarit të punës. Nëse keni vështirësi në kryerjen e detyrave të punës, atëherë kërkoni punë më pak të mundimshme. Nëse në fund të shtatzënisë keni ankësuar shëndetësore, kërkoni nga mjeku juaj të ju lëshojë vërtetimin e pushimit mjekësor shëndetësor.

Shëndeti

Gjatë shtatzënisë firma juaj mund të ju ngarkojë me detyra pune vetëm me aprovimin tuaj. Kjo domethënë se ju mund të refuzoni punët, të cilat për ju paraqesin ngarkesë fizike. Pos kësaj ekziston edhe një listë e detyrueshme e punëve, nga të cilat firma juaj duhet të ju lirojë. Ju nuk guxonin fjala bie të ngriheni pesha të rënda dhe nuk guxonin ti nënshtroheni zhurmës së lartë. Informata në: <http://goo.gl/KHEgMs>

Orari i punës

Nëse dëshironi mund të kryeni punë në mbrëmje dhe natën (mes orës 20 dhe orës 6). Mirëpo shefi juaj nuk guxon të ju detyrojë. Nëse nuk jeni të pajtimit me orarin e punëve të vona, firma juaj duhet të ju ngarkojë me punë të barasvlershme ditën. Në tetë javët e fundit të shtatzënisë puna mbrëmjeve dhe natën ndalohe tërësisht.


Punë zëvendësuese

Për punët e rënda, të cilat nuk mund apo nuk guxonin ti kryeni më tej, ndërmarrja juaj duhet të ju ngarkojë punë zëvendësuese, të cilat janë të barasvlershme. Punë që ju përgjigjen si profesionalisht ashtu edhe shpirtërisht sikur veprimtaria juaj personale. Nëse diçka e tillë nuk është e mundur, do të liroheni nga kryerja e punëve dhe merrni edhe më tej 80% të pagës suaj.

Pas lindjes

Tetë javët e para pas lindjes nuk guxonin të punoni fare. Ju keni të drejtën ligjore për së paku 14 javë pushim lehonie. Ka edhe firma, të cilat kërkojnë që nënat pas 8 javësh të dalin përsëri në punë. Mirëpo mos lejoni të ju bëjnë presion, pasi që posa të nisni punën përfundon e drjta juaj për kompensim zëvendësues. Pra ju nuk mundeni që më vonë të ndërtoni përsëri mendje, edhe nëse puna është ngarkesë e mundimshme.

⇒ Sina Bühler, work 20.2.2014



Përveç të tjerash:

Ekziston edhe një listë e gjatë me punë të rënda apo të rrezikshme, të cilat gjatë shtatzënisë dhe kohës së dhënies së gjirit nuk guxojnë të kryhen apo vetëm në mënyrë të kufizuar (Ligji i Punës, Neni 35, Ligji i Punës, Urdhëresa 1, Neni 62 i rregullores për mbrojtjen e nënës).

Unia di më shumë dhe ju këshillo me dëshirë!



Broshura e Unia-s mbi temën

Broshurën e deritashme e Unia-s për gra dhe nëna shtatzëna mund ta gjeni tek: <http://goo.gl/qINAFs> (në gjermanisht, frëngjisht, italisht, shqip si dhe gjuhët tjera relevante të migrantëve). Në javët e ardhshme ajo do të përpunohet dhe do të vihet rishtas në rrjet në dispozicion. Arsyet: Tani rishtas është duke u përcaktuar artikujt ligjor për dhënie gjiri me pagesë.

Intervistë



Katja Signer Hofer

Paga minimale na mbron të gjithëve

A ka nevojë Zvicra për pagën ligjore minimale? Për këtë do të votohet më 18 maj 2014. Sceptikët e kars-hi kësaj iniciative të Unionit të Sindikatave të Zvicrës (SGB) druajnë posaçërisht humbjen e vendeve të punës. Katja Hofer, zëdhënësjja e sindikatës Unia në vijim eliminon disa nga dyshimet.

Përse i nevojitet Zvicrës paga minimale?

Zvicra është një vend i pasur dhe megjithatë mbi 330000 persona për punën me orar të plotë fitojnë më pak se 4000 Franga në muaj. Derisa në të njëjtën kohë vetëm pak veta zhvatin pakursyer, të tjerët me pagat e tyre të mjerueshme mesia ia dalin deri në fund të muajit. Një llogari e papritur e dentistit mundet shpejt ta prish baraspeshimin e financave. Të gjithë ata që punojnë me orar të plotë, duhet që nga paga e tyre të mund të jetojnë. Këtë duam ta arrijmë ne me iniciativën tonë. Paga minimale nuk siguron vetëm paga korrekte. Njëkohësisht kjo i pamundëson punëmarrësit që të punësojë fuqi të lirë punëtore, për të shtypur kështu pagat e të gjithëve. Kështu paga minimale mbron pagat e të gjithë neve.

Kush janë njerëzit me paga të ulëta

Shumica kanë të kryer shkollimin profesional, janë arsimuar më tej si dhe posedojnë përvojë të gjatë pune. Nuk është e vërtetë se vetëm të rinjtë dhe ata papërvojë fitojnë keq. Tre nga katër të prekurit nga pagat e ulëta janë në moshën mbi 25 vjeç, një e treta e tyre posedojnë kualifikime profesionale. Mbi mesataren janë të prekura gratë. Paga minimale do të ishte hapi i duhur drejt barazisë në paga!

A nuk do të qoj iniciativa në humbjen e vendeve të punës, pasi shumë firma nuk mund të paguajnë paga më të larta?

Ky është frikësim gjithmonë i njëjtë. Edhe atëherë kur para 10 vjetësh sindikatat udhëhoqën kampanjën «Jo pagë nën 3000 Franga» punëdhënësit kishin frikë dhe tërhiqnin vërejtjen për shkarkime nga puna. Nuk pat ndodhur asgjë. Në gastronomi shembulli bie u patën ngritur pagat për rreth 1000 Frangave – pa kushtuar me ndonjë vend të humbur pune.

Por ka edhe sektor tjerë ekonomik që preken...?

Paga të ulëta ka para së gjithash edhe në sektorin e shitjes, në pastrim dhe në sallone floktarie, mirëpo edhe në industri. Edhe në këta sektor paga minimale do të ishte e përbalueshme. Në sektorin e pastrimit do të rritshin çmimet për pak përqindje. Në shitjen me pakicë shumë shitore zinxhirë janë në pronësi të familjeve me pasuri të rëndë. Këtu posedohen mjaft para për ti paguar të gjithë më korrektësi.

Mirëpo vendet me paga minimale u kanë punët keq? Të krahasojmë vetëm Francën dhe Suedinë...

Edhe Organizatat e «padyshimta» sikur OECD apo Organizata Ndërkombëtare e Punës ILO janë për pagën minimale – pasi e dinë se kështu mund të luftohen pagat e ulëta dhe ti epet fund dumpingut në paga. Edhe në Francë paga minimale ka zvogëluar fuqishëm numrin e punëtorëve me paga të ulëta. Atje kemi problemin që punëdhënësit, për punëmarrësit të cilët marrin «SMIC», duhet të paguajnë më pak kontribute në sigurimet shoqërore. Andaj shumë nga ta ka zbritur lehtë pagat pak më të larta me nivelin e pagave minimale. Iniciativa jonë nuk parasheh këtë marrëzi. Në Suedi janë mbi 90% e të gjithë të punësuarve përmes Kontratave Kolektive të Punës të mbrojtur. Këtu janë përafërsisht gjysma, pra jo të gjithë marrin pagën minimale me KKP. Andaj me 18 maj nevojitet të votohet me PO iniciativa për pagën minimale.

Solidarizim me grevistët – ish punëtorët e fabrikës së gypave të Ferizajt

Jemi me ju – grevistët!



Pjesëmarrësit e seminarit për aktivistëve shqiptar të sindikatë Unia në foto solidariteti

Greva e filluar më 13.03.2014, e cila organizohet për shkak se Institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës (Qeveria dhe AKP-ja) nuk po e ekzekutojnë Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010, respektivisht refuzojnë të paguajnë borxhin punonjësve të Fabrikës së Gypave të Ferizajt. Grevistët kanë shtruar 6 kërkesa dhe ata janë të vendosur që Greva do të përfundon vetëm atëherë kur të realizohen kërkesat e tyre.

Pjesëmarrësit e seminarit të radhës për aktivistët sindikal shqiptar në kuadër të sindikatës Unia, në të cilën aderohet mbi 15 000 anëtarë me prejardhje shqiptare, unanimisht u pajtuan të shprehin solidaritetin e plotë sindikalist e shoqëror me punëtorët e Fabrikës së Tubave të Ferizajt, të cilët janë duke protestuar tani e disa ditë para objektivit të Qeverisë së Kosovës. Protestat dhe greva e tyre janë të drejta dhe të bazuara edhe në ligj. Për më shumë vendimi i Gjykatës Kushtetuese e bënë tërësisht të ligjshme këtë kërkesë.

Qeveria të paguajë borxhin

Ne solidarizohemi me këtë organizim të kolegëve e bashkëqytetarëve tanë punëtor, si shprehje e lartë e vetëdijes së tyre politike në përpjekjen e përbashkët për transformime shoqërore.

Institucionet përgjegjëse të Kosovës duhet pa stërzgjatje dhe në mënyrë të përpiktë ta zbatojë këtë vendim dhe t'i plotësojë të gjitha kërkesat e drejta të këtyre punëtorëve.



Do ta fuqizojmë solidaritetin

Aktivistët shqiptar dhe sekretaret e sindikatës Unia në ditët e ardhshme do të kërkojnë që jo vetëm sindikata Unia, por edhe sindikatat tjera, Unioni i Sindikatave të Zvicrës si dhe shoqatat tjera shqiptare, migrante e vendore të shprehin solidaritetin me punëtorët grevist të ish Fabrikës së Gypave në Ferizaj.

Vetëm të bashkuar do të arrijmë një jetë më të drejtë dhe me më dinjitet! Jemi deri në fund me punëtorët grevist!

Osman Osmani,

sekretar sindikal për migracion në sindikatën Unia

Kërkesat e grevistëve

1. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kryeministri z. Hashim Thaqi dhe nga Bordi i AKP-së (Agjencisë Kosovare të Privatizimit) që deri më 14 mars 2014, caktojnë përfaqësuesit e tyre për të nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit, për fillimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010.
2. Kërkojmë që nënshkrimi i Memorandum mirëkuptimit për implementimin-ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010, si dhe Rekomandimit të rikonfirmuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i datës 23.01.2014, të bëhet më 15 mars 2014 .
3. Kërkojmë nga palët që t'i përbahen në mënyrë strikte Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010 dhe Rekomandimit të rikonfirmuar të Kuvendit Republikës së Kosovës i datës 23.01.2014
4. Varësisht prej përbushjes së kërkesave, mund të shtohen dhe kërkesa të tjera.
5. Kërkojmë nga mediat elektronike dhe ato të shkruara të pasqyrojnë drejtë dhe saktë grevën tonë.
6. Greva do të përfundon atëherë kur të realizohen kërkesat tona.

Për Këshillin Grevist: Ali Shabani, kryetar



Pamje gjatë zhvillimit të seminarit që temë kryesore kishte pagën minimale në Zvicër

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Pensioni i pleqërisë për qytetarët e Kosovës:

A duhet të kem kujdes nëse dua të kthehem në vendlindje në moshë të pleqërisë?

Babai im H. H. është pensionist i Zvicrës dhe ka punuar për 35 vjet. Tani e ka moshën e pensionet. Ai ka dëshirë që të jetoj në Kosovë dhe pensionin ta marr në vendlindje. Pyetja ime është, a do të arrihet marrëveshja e re sivjet, apo sa kohë zgjat deri tek ajo. Dihet se me pension të vogël të pleqërisë është e vështirë përballimi i harxhimeve jetësore këtu, andaj pyetja ime është, a ia vlen që prindi im në këtë situatë të kthehet në Kosovë?

Nga 1 prilli i vitit 2010, Zvicra njëanshëm nuk vijon të zbatojë Marrëveshjen ndërshtetërore për Sigurimet Shoqërore në raport me Republikën e Kosovës. Kjo domethënë, që një qytetar i Republikës Kosovës që nuk ka vendbanim të rregullt në Zvicër, nuk do të ketë të drejtë të marr pensionin në Kosovë, apo në ndonjë vend jashtë Zvicrës. Pra çdo vendim i marr nga kjo datë (1 prill 2010) e tuje në mungesë të Marrëveshjes nuk siguron përfitimet për të gjithë ata persona që janë kthyer përfundimisht në Kosovë. Ndryshe qëndron puna, nëse prindi (baba) juaj ka edhe shtetësi zvicerane. Atëherë ai ka të drejtë të eksportojë në çdo vend tjetër të botës pensionin e vet të pleqërisë apo edhe atë invaliditetit.

Edhe përkundër faktit mbulohen harxhimet elementare jetësore, kur dihet se me shtyre të moshës edhe nevojat për mbështetje shtesë si shëndetësore ashtu edhe jetësore në përgjithësi rriten. Ndërsa në Kosovë me pensionin e tij të merituar, prindi juaj do të bënte një jetë shumë më e lirë dhe ndoshta edhe më e mirë. Unë e kuptoj brengën e juaj, se jeta në Zvicër me një pension të vogël është e vështirë të përballohet, megjithatë këshilloheni që prindi juaj, në asnjë rast dhe në asnjë mënyrë, të mos heq dorë nga vendbanimi i rregullt në Zvicër, pa arritjen e një Marrëveshje të re ndërshtetërore për Sigurimet Shoqërore mes Zvicrës e Kosovës. Negocimi i një Marrëveshje të re në fjalë mund të zgjas dy-tri vite, ndërsa mjerisht bisedimet as që kanë filluar.

Procedurat për tërheqjen e kontributeve nga kolona e parë Kujdes nga spekulantët! Mbushja e formularit nuk duhet të kushtojë asgjë.

Quhem R. dhe jetoj në Kosovë. Kam punuar mbi 9 vite në Zvicër dhe për ato vite kam paguar rregullisht kontributet për pension. A mund të jepni më shumë informacione për tërheqjen (marrjen) e këtyre parave të pensionit dhe mundësisht më informoni si janë procedurat dhe rregulla për këtë çështje?!

Ashtu si kemi preferuar në informatën tonë të publikuar dhe të lexuar në RTK, deri në arritjen e një marrëveshje të re nuk është e domosdoshme që të kërkonti menjëherë kthimin e kontributeve nga kolona e parë e sigurimeve shoqërore, nëse nuk ndodheni para moshës së pensionit të pleqërisë, respektivisht nëse nuk ndodheni para mbarimit të afatit të parashkrimit (vjetrimit).

Duhet të dini se e drejta në kthimin e kontributeve skadon tek pesë vite pas arritjes së moshës së rregullt të pensionit (64 vjeçare për femra dhe 65 për meshkuj). Në rast të mosarritjes së marrëveshjes së re kontributet tuaja mund të tërhiqen, para skadimit të afatit pesëvjeçar të vjetërimit pas arritjes së moshës së pleqërisë. Tek rasti juaj konkret varet edhe nga mosha juaj dhe synimi e vendimi juaj. Në mungesë të zbatimit të Marrëveshjes në fjalë, disa veta edhe kanë tërhequr kontributet e tyre, që si mjete janë shumë më të pakta se sa në rast të përfitimit të pensionit të pleqërisë (principi i solidaritetit të gjeneratave) dhe fakti që duhet të kihet gjithsesi parasysh është se me nënshkrimin tuaj për tërheqjen e menjëherëshme të kontributeve, hiqni dorë përfundimisht nga çdo e drejtë në pension në të ardhmen. Edhe nëse vendosni për diçka të tillë, keni kujdes dhe mos bini pre e spekulantëve të ndryshëm, por shkarkojeni formularin përkatës nga faqja zyrtare e Entit kompetent të Zvicrës apo të Kosovës dhe mbusheni atë. Nëse këtë punë nuk dini apo nuk mundeni ta kryeni vet, atëherë kërkonti ndihmën e të afërmeve edhe miqve tuaj dhe mos u harxhoni kot.

Osman Osmani

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion "Horizonte", Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch